



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1223/6 prot

Datë 12/07/2022

V E N D I M
K.P.P.649/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12/07/2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Enea Masllavica” PERSON FIZIK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-28121-05-10-2022, me objekt: “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake”, me fond limit 4.088.333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: “Enea Masllavica” PERSON FIZIK
Adresa: Rruga “e Dibrës”, pranë Komisarariatit nr.4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Adresa: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.05.2022 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-28121-05-10-2022, me objekt: “Blerje uniforme për Policinë Bashkiake”, me fond limit 4.088.333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 24.05.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe verifikimeve në SPE, rezultojnë në datën 02.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojnë si më poshtë vijon:

- “Enea Masllavica” PERSON FIZIK	3.354.150,00	I skualifikuar
- “AMEL - E. Z” SHPK	3.699.100,00	I skualifikuar
- “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK	3.724.710,00	I kualifikuar

II.4. Në datën 02.06.2022 operatori ekonomik ankimues “Enea Masllavica” PERSON FIZIK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyen si më poshtë vijon.

“- Për ofertuesin ENEA MASLLAVICA P.F me Nipt L71920001R me vlerë të ofertës 3.354.150 leke, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht: - Në pikën 2.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” gërma b, është kërkuar: Certifikatë: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ofertuesi ENEA MASLLAVICA .PF nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi ISO 9001 ka skaduar më datë 14.05.2022. KVO vendos që ENEA MASLLAVICA .PF të mos kualifikohet”.

II.5. Në datën 07.06.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 08.06.2022 operatori ekonomik ankimues “Enea Masllavica” PERSON FIZIK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ndërsa më datë 10.06.2022 i njëjti operator ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.7. Në ankesë ngrihen pretendime nga ana e operatorit ekonomik “Enea Masllavica” PERSON FIZIK si më poshtë vijon:

“Në zbatim të pikës 2 të “Kritereve të veçanta për kualifikimin” , pika 2.5-b Kapaciteti Teknik kërkohet :

b. Certifikatë: ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në datën 02.06.2022 ora 13:48, nëpërmjet SPE kemi marrë njoftimin e KVO nga ku rezulton se jemi skualifikuar me pretendimin se:

- Për ofertuesin ENEA MASLLAVICA P.F me Nipt L71920001R me vlerë të ofertës 3.354.150 leke, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht: - Në pikën 2.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” gërma b, është kërkuar: Certifikatë: ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga

një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ofertuesi ENEA MASLLAVICA .PF nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi ISO 9001 ka skaduar më datë 14.05.2022. KVO vendos që ENEA MASLLAVICA .PF të mos kualifikohet.

Argumenti i KVO për skualifikimi tonë për ne nuk qëndron pasi siç shprehet edhe në DST pika 2-b Kapaciteti Teknik, për tu kualifikuar një OE duhet të paraqesë:

b. Certifikate: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, Menaxhim të cilësisë ne kemi dorëzuar certifikatën ISO

Në zbatim të kësaj kërkesë ne kemi dorëzuar certifikatën ISO 9001:2015 me NR: SISTEMA/ALB/0521Q156 e vlefshme edhe në datën e zhvillimit të procedurës, e cila ka të shënuar si datë lëshimi të parë datën 15.05.2022 dhe më pas ka të shënuar mbikëqyrja e parë 15.04.2022, mbikëqyrja e dytë 15.04.2023. Pra siç mund të shikohet edhe nga datat që mban të shënuara certifikata ajo është e vlefshme edhe përtej vitit 2023 dhe jo më në datën 24.05.2022 kur është zhvilluar kjo procedurë prokurimi. Ne kemi dyshim të arsyeshëm mbi vendimin e KVO-së pasi në qoftë se ajo, pra KVO-ja do ti ishte drejtuar me kërkesë autoritetit lëshues të certifikatës, do të kishte marrë përgjigjen e saktë për vlefshmërinë apo jo të kësaj certifikate. KVO do të duhet ta dijë se të gjitha certifikatat e kësaj natyre lëshohen për jo më pak se 3 (tre) vjet.

Ne kemi komunikuar nëpërmjet emailit me autoritetin certifikues dhe ata na pohojnë se vlefshmëria e certifikatës përfundon pas periudhës tre vjeçare.

(Komunikimi me email:

Më datë 06.08.2022, znj. Ina përfaqësuese kompanisë “General Control and Certification” SHPK, në cilësinë e përfaqësuesit të kompanisë SISTEMA (kompania që ka lëshuar certifikatën) i dërgon operatorit ekonomik ankimes “Enea Masllavica” PERSON FIZIK, e-mail me përmbajtje si më poshtë vijon:

Përshëndetje,

Bazuar në kërkesen tuaj si më lart, ju sqarojmë:

Kompania General Control and Certification ShPK është përfaqësuese e kompanisë SISTEMA (kompania që ka lëshuar certifikatën).

Sipas rregullave të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim, çdo kompani e certifikuar pas një auditimi të suksesshëm pajiset me certifikatën përkatëse për një afat 3-vjeçar, por me të drejtën e mbikëqyrjeve vjetore.

Certifikata juaj me Nr. SISTEMA/ALB/0521Q156 ka qenë e vlefshme siç citohet në certifikatë, por pas përfundimit të auditimit dhe raportit të dorëzuar, gjatë kohës që ju keni dorëzuar këtë certifikatë pranë një autoriteti kontraktor, ne kemi qenë në pritje të lëshimit të certifikatës së re.

Pavarësisht këtij fakti, në rast se autoriteti kontraktor ka kryer verifikimet e duhura në website, certifikata juaj ka qenë aktive (e vlefshme) dhe vazhdon të jetë aktive pas mbikëqyrjes vjetore të suksesshme.

Ne nuk jemi kontaktuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, pasi në certifikatë autoriteteve kontraktore ju jepet e drejta të kryejnë verifikimet e nevojshme.

Ju faleminderit që na keni kontaktuar,

Kind Regards,

Ina.).

Ndërkohë që ne po paraqesim këtë ankesë autoriteti certifikues ka përfunduar auditimin e radhës dhe na ka pajisur me certifikatë të re. Bashkëlidhur kësaj kërkesë ju lutemi gjeni edhe korrespondencën me autoritetin certifikues.

Për sa kohë që lëshuesi i certifikatës pohon që është e vlefshme, nuk e dimë ku e gjen guximin KVO për të skualifikuar ofertën tonë, për më tepër që ajo është edhe oferta më ekonomike.

Prandaj për "ne" ky argument skualifikimi nga ana e KVO-së nuk qëndron.

Nisur nga kjo, kërkojmë:

1- Rrëzimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin tonë.

2- Kualifikimin e ofertës tonë, si të vlefshme edhe më ekonomike.”.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1223/2 prot, date 09.06.2022 duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Në përfundim të afatit ligjor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1223/3 prot, datë 22.06.2022 “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Enea Masllavica” PERSON FIZIK, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Enea Masllavica” PERSON FIZIK.

II.9. Me shkresën nr. 2761/8 prot, datë 28.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1223/4 prot datë 01.07.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky

i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Enea Masllavica” PERSON FIZIK dhe ka vendosur mospranimin e pretendimeve të ankimuesit konkretisht si më poshtë:

“KSHA gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me arsyen e skualifikimit nuk qëndron, duke arsyetuar si më poshtë:

Në shtojcën 7, pika 2.3. b “Për kapacitetin teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: “b.) Certifikatë: ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”.

Ndërsa në paragrafin e fundit të shtojcës 7 thuhet: “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”.

Operatori Ekonomik “Enea Masllavica” person fizik, për të vërtetuar plotësimin e kriterit të sipërcituar, ka ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike Certifikatën: ISO 9001:2015, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë me Nr. SISTEMA/ALB/0521Q156.

Pas verifikimit të certifikatës: ISO 9001 :2015, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së operatorit ekonomik ankimues me Nr. SISTEMA/ALB/0521Q156 vërehet se data e lëshimit të saj është data 15.05.2021, ndërsa data e skadimit është data 14.05.2022.

Sqarojmë se operatori ekonomik ankimues në datën 19.05.2022 ka depozituar në SPE Certifikatën: ISO 9001 : 2015, certifikatë e cila është tej afatit të skadimit. Lidhur me këtë fakt KSHA gjykon se kjo certifikatë ka skaduar më datë 14.05.2022, përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 l “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe DST-së përkatëse,

VENDOS:

I. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Enea Masllavica” person fizik, për kontratën me numër të referencës së procedurës: REF-28121-05-10-2022, me objekt: “Blerje uniforme për Policinë Bashkiake”, me fond limit: 4.088.333 (katër milion e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa-TVSH, zhvilluar me datë 24.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.”.

II.10. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, si dhe komunikimeve në rrugë elektronike me i cili thekson se certifikata ISO 9001 :2015, me Nr. SISTEMA/ALB/0521Q156 të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Enea Masllavica”

PERSON FIZIK, ka qenë e vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua më datë 06.07.2022 me anë të emailit organit certifikues SISTEMA CERTIFICATIONS & INSPECTIONS, i cili ka lëshuar këtë certifikatë, duke kërkuar verifikimin e vlefshmërisë së tyre.

II.11. Në datën 06.07.2022 organi certifikues SISTEMA CERTIFICATIONS & INSPECTIONS i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë, në të cilën është dhënë informacioni i kërkuar mbi vlefshmërinë e certifikatës ISO 9001 :2015, me Nr. SISTEMA/ALB/0521Q156 të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “Enea Masllavica” PERSON FIZIK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Enea Masllavica” PERSON FIZIK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së dorëzuar prej tij me arsyetimin se: *“Argumenti i KVO për skualifikimin tonë për ne nuk qëndron pasi siç shprehet edhe në DST pika 2-b Kapaciteti Teknik, për tu kualifikuar nje OE duhet të paraqesë:*

b. Certifikate: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, Menaxhim të cilësisë ne kemi dorëzuar certifikatën ISO.

Në zbatim të kësaj kërkesë ne kemi dorëzuar certifikatën ISO 9001:2015 me NR: SISTEMA/ALB/0521Q156 e vlefshme edhe në datën e zhvillimit të procedurës, e cila ka të shënuar si datë lëshimi të parë datën 15.05.20221 dhe më pas ka të shënuar mbikëqyrja e parë 15.04.2022, mbikëqyrja e dytë 15.04.2023. Pra siç mund të shikohet edhe nga datat që mban të shënuara certifikata ajo është e vlefshme edhe përtej vitit 2023 dhe jo më në datën 24.05.2022 kur është zhvilluar kjo procedurë prokurimi. Ne kemi dyshim të arsyeshëm mbi vendimin e KVO-së pasi në qoftë se ajo, pra KVO-ja do ti ishte drejtuar me kërkesë autoritetit lëshues të certifikatës, do të kishte marrë përgjigjen e saktë për vlefshmërinë apo jo të kësaj certifikate. KVO do të duhet ta dijë se të gjitha certifikatat e kësaj natyre lëshohen për jo më pak se 3 (tre) vjet.

Ne kemi komunikuar nëpërmjet emailit me autoritetin certifikues dhe ata na pohojnë se vlefshmëria e certifikatës përfundon pas periudhës tre vjeçare.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3/b “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

b) Certifikate: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatorit ekonomik ankimues “Enea Masllavica” PERSON FIZIK në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatën ISO 9001:2015 “Sistemit të Menaxhimit” në gjuhën shqipe, me numër: SISTEMA/ALB/0521Q156, të lëshuar për shoqërinë “Enea Masllavica” PERSON FIZIK nga trupa certifikuese “SISTEMA Certifications and Inspections”, të lëshuar më datë 15.05.2021 dhe me datë skadimi 14.05.2022, ndërkohë që mbikëqyrja e parë do të bëhet më datë 15.04.2022, ndërsa mbikëqyrja e dytë do të bëhet më datë 15.04.2023.

III.1.3. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.4. Në nenin 79 pika 1 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”.

III.1.5. Në nenin 40 pika 7 germa c) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.”

III.1.6. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.7. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, në datën dhe orën e hapjes së procedurës duhet të paraqesin në sistemin elektronik të prokurimit (SPE) certifikatën ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë e saktë sipas shënimit në fund të shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit.

III.1.8. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Enea Masllavica” PERSON FIZIK, i cili kundërshton arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor lidhur me faktin se certifikata ISO 9001:2015 me numër: SISTEMA/ALB/0521Q156 është e pavlefshme, pasi ka skaduar më datë 14.05.2022, ndërkohë që procedura e prokurimit është zhvilluar më datë 24.05.2022, ku ankimuesi argumenton se sipas komunikimit në rrugë elektronike me shoqërinë “General Control and Certification” SHPK, në cilësinë e përfaqësuesit të kompanisë SISTEMA (kompania që ka lëshuar certifikatën) është njoftuar prej kësaj kompanie, se certifikata ISO 9001:2015 me numër: SISTEMA/ALB/0521Q156 ka qenë e vlefshme siç citohet në certifikatë, por pas përfundimit të auditimit dhe raportit të dorëzuar, gjatë kohës që ju keni dorëzuar këtë certifikatë pranë një autoriteti kontraktor, ne kemi qenë në pritje të lëshimit të certifikatës së re, pra pavarësisht këtij fakti, në rast se autoriteti kontraktor ka kryer verifikimet e duhura në website, certifikata juaj ka qenë aktive (e vlefshme) dhe vazhdon të jetë aktive pas mbikëqyrjes vjetore të suksesshme.

Lidhur me këto argumente të ankimuesit, arsyes së skualifikimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua më datë 06.07.2022 me anë të emailit organit certifikues SISTEMA CERTIFICATIONS & INSPECTIONS lëshues të certifikatës ISO 9001:2015 me numër: SISTEMA/ALB/0521Q156, duke i kërkuar informacion lidhur me vlefshmërinë e kësaj certifikate, ku këtë të fundit ia dërguam bashkëlidhur E-mail-it.

III.1.9. Në datën 06.07.2022 organi certifikues “SISTEMA CERTIFICATIONS & INSPECTIONS” i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë lidhur me vlefshmërinë e certifikatës ISO 9001:2015 me numër: SISTEMA/ALB/0521Q156, ku informon se:

”Kopja e bashkëngjitur e certifikatës dërguar nga ana juaj nuk është e përditësuar.

Këtu po bashkëngjisim kopjen e përditësuar të certifikatës dhe e njëjta vlen.

Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim, ju lutemi na tregoni, ne jemi të lumtur të diskutojmë.

Ku bashkëlidhur këtij mesazhi ka dërguar Certifikatën ISO 9001:2015 me numër: SISTEMA/ALB/0521Q156 të lëshuar për shoqërinë “Enea Masllavica” PERSON FIZIK nga trupa certifikuese “SISTEMA Certifications and Inspections”, me datë lëshimi fillestare 15.05.2021, me datë të lëshimit 02.06.2022 dhe me datë skadimi 14.05.2023, ndërkohë që mbikëqyrja e dytë do të bëhet më datë 15.04.2023, ndërsa ricertifikimi do të bëhet më datë 15.04.2024.”.

III.1.10. Referuar kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3/b “Kapaciteti teknik” dhe shënimit në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që ofertuesit për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues duhet të dorëzojnë Certifikatën ISO 9001:2015, por me kushtin që ky dokument të jetë i saktë, ndaj për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues ofertuesi “Enea Masllavica” PERSON FIZIK në datën e hapjes së ofertave më datë 24.05.2022 ka dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit (SPE) Certifikatën ISO 9001:2015 me numër: SISTEMA/ALB/0521Q156 të lëshuar nga trupa certifikuese “SISTEMA Certifications and Inspections”, ku në përmbajtjen e saj thuhet se kjo certifikatë skadon më datë 14.05.2022 sikurse ka konstatuar komisioni i

vlerësimin të ofertave, ndërkohë që referuar korrespondencës midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe trupës certifikuese “SISTEMA Certifications and Inspections”, u informuam prej këtij të fundit se certifikata e dorëzuar në SPE nga ankimuesi nuk është e përditësuar, duke vënë në dispozicion certifikatën ISO 9001:2015 të përditësuar të lëshuar më datë 02.06.2022 dhe me vlefshmëri deri më datë 14.05.2023.

Komisioni konstaton, se Certifikatën ISO 9001:2015 me numër: SISTEMA/ALB/0521Q156 e dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit (SPE) nga ana e ofertuesit “Enea Masllavica” PERSON FIZIK nuk është e saktë dhe e vlefshme, pasi nuk është e përditësuar, sepse perioda kohore nga data 14.05.2022 deri në datë 02.06.2022 është perioda kohore e nevojshme gjatë së cilës trupa certifikuese ka bërë mbikëqyrjen e parë dhe pas mbarimit më sukses të mbikëqyrjes më datë 02.06.2022 kjo shoqëri është pajisur më certifikatën e re të përditësuar ISO 9001:2015, ndërkohë që në momentin e dorëzimit të ofertave më datë 24.05.2022, kjo shoqëri ka dorëzuar certifikatën ISO 9001:2015 e cila ka qenë e papërditësuar, pra e pasaktë dhe e pavlefshme.

Për rrjedhojë KPP gjykon, se operatori ekonomik “Enea Masllavica” PERSON FIZIK me dokumentacionin e paraqitur, nuk plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3/b “Kapaciteti teknik” dhe shënimit në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi lidhur me dorëzimin e certifikatës ISO 9001:2015, origjinale, ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara, të sakta dhe të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Enea Masllavica” PERSON FIZIK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Enea Masllavica” PERSON FIZIK për procedurën e prokurimit procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-28121-05-10-2022, me objekt: “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake”, me fond limit 4.088.333 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 24.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Enea Masllavica” PERSON FIZIK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri